



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Kodin e punës së KEK Sh.a, si dhe në baze të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës në Divizionet e KEK-ut, UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore, më 16.04.2024 që të publikojë ofertën për pozitat e mëposhtme:

KONKURS



Titulli i pozitës:	Teknik i Elektroenergjetikës
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës (Tri Divizionet)
Numri i referencës:	02-16.04.2024
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012 dhe UA 01/2024
Titulli i mbikëqyrësit:	Prijësi i ekipit/koordinatori/Inxhinieri i kryerjes/inxhinieri përgjegjës/udhëheqësi i sektorit
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj
Koeficienti-paga:	676 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	149
Vendi i punës:	Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë

Punon sipas urdhërësive të cilat i shtron prijësi i ekipit dhe inxhinieri i kryerjes, përpunon dhe vizaton dokumentacionin e nevojshëm për meremetimin e makinave elektrike në Departamentin e Elektrikës/Mirëmbajtjes. Përgjigjet për kualitetin dhe kuantitetin e punës. Kryerja e punëve të mirëmbajtjes së pajisjeve të elektrikes sipas urdhërësës së punës së inxhinierit përgjegjës përmes prijësit të ekipit, inxhinierit të kryerjes dhe organizmit që bënë inxhinieri i kryerjes si dhe kryerja e punëve sipas mirëmbajtjes preventive.

Zbaton urdhëresat e punës nga udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe udhëheqësit tjerë në vijën organizative si dhe jep propozime për përmirësime të nevojshme në sistemin e Departamentit të Elektrikes/Mirëmbajtjes.

Sistemimi dhe ruajtja e dokumentacionit teknik për pajisjet në përgjegjësinë e vet.

Jep propozime për përmirësime të nevojshme në sistemin e elektrikes nën përgjegjësinë e vet duke përcjellë problematiken e përditshme.

Respektimi rigoroz i udhëzimeve për mirëmbajtje, që janë përgatitur nga teknologu përgjegjës në bazë të udhëzimeve nga prodhuesi i pajisjeve. Respektimi i masave të sigurisë në punë që kërkohen në vendndodhje nga zyrtari i sigurisë.

Autorizimet: Te kërkojë ndihmë nga stafi udhëheqës apo edhe nga kolegët tjerë për zgjidhjen e problemeve specifike.

Raportimet: Drejtpërdrejt i raporton: prijësit të ekipit, koordinatorit, inxhinierit të kryerjes, inxhinierit përgjegjës, udhëheqësit të sektorit apo sipas nevojës edhe kryeinxhinierit.

Vartësit e Drejtpërdrejtë: Bashkëpunon me inxhinierin e kryerjes si dhe inxhinierin përgjegjës si dhe personelin tjetër në grupin përkatës.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Shkollimi: Shkolla e mesme teknike ose elektroteknike

Dega/drejtimi/lëmia: Elektroteknika

Profili:

- 1) Elektroteknik i reparteve motorike
- 2) Teknik i energjetikes
- 3) Teknik i makinave elektrike
- 4) Teknik i elektroteknikes (shkollat e vjetra kur kanë qenë si shkollë teknike)
- 5) Instalues elektrik

Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip.

Të dëshmojë aftësi për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës.

Nivel të lartë të motivimit, iniciativë, vendosmëri, intuitë dhe vëmendje në detaje.

Nivel të lartë të etikës profesionale.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- a. Aplikacionin-CV-në e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: **"Ngarko Aplikacionin-CV-në e plotësuar"**
- b. Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës së mesme (ose Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme)** e skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në

aplikimin online të vegëza “Ngarko dëshmitë e kualifikimit“. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online. Dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkesave në konkurs. Pas aplikimit të suksesshëm do të pranoni një email për konfirmim. Nëse nuk keni pranuar emailin konfirmues, atëherë kontaktoni në nr e tel. 038 501-401-2671, ose shkruani në email adresën ofertapune@kek-energy.com (vetem në rastin kur pas aplikimit nuk e keni pranuar e-malin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet në tabelën e shpalljeve në KEK, gjithashtu kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi, duke respektuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Testimi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetepërshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Testimi me shkrim do të bëhet në formë elektronike ashtu që vlerësimi do të jetë automatik.

Procesi i testimit dhe intervistimit për kandidatët e suksesshëm me qëllim të transparencës do të monitorohet nga kamerat.

Titulli i pozitës:

Teknik i Elektronikes

Institucioni:

Korporata Energjetike e Kosovës (Tri Divizionet)

Numri i referencës:

02-17.04.2024

Tipi Akt Emërimit të punës:

Sipas Ligjit të punës 03/L-2012 dhe UA01/2024

Titulli i mbikëqyrësit:

Prijësi i ekipit, koordinatori, inxhinieri i kryerjes, inxhinieri përgjegjës, udhëheqësi i sektorit,

Kohëzgjatja e kontratës:

1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.

Koeficienti-paga:

676 euro

Procedura e aplikimit:

1 jashtëm

Numri i kërkuar:

31

Vendi i punës:

Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës është i obliguar të punojë sipas urdhëresave të cilat i shtron prijësi i ekipit dhe inxhinieri i kryerjes. Kryen punët e mirëmbajtjes së pajisjeve të Departamentit të Elektrikes/Mirëmbajtjes sipas urdhëresës së punës së inxhinierit përgjegjës përmes prijësit të ekipit, inxhinierit të kryerjes dhe organizmit që bën inxhinieri i kryerjes si dhe kryerja e punëve sipas mirëmbajtjes preventive.

Zbaton urdhëresat e punës nga udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe udhëheqësit tjerë në vijën organizative.

Sistemimi dhe ruajtja e dokumentacionit teknik për pajisjet në përgjegjësinë e vet.

Jep propozime për përmirësimet e nevojshme në sistemin e Departamentit të Elektrikes/Mirëmbajtjes nën përgjegjësinë e vet duke përcjellë problematiken e përditshme.

Respektimi rigoroz i udhëzimeve për mirëmbajtje që janë përgatitur nga teknologu përgjegjës në bazë të udhëzimeve nga prodhuesi i pajisjeve.

Respektimi i masave të sigurisë në punë që kërkohen në vendndodhje nga zyrtari i sigurisë.

Autorizimet: Te kërkojë ndihmë nga stafi udhëheqës apo edhe nga kolegët tjerë për zgjedhjen e problemeve specifike.

Raportimet: Drejtpërdrejt i raporton: prijësit të ekipit, koordinatorit, inxhinierit të kryerjes, inxhinierit përgjegjës, udhëheqësit të sektorit, apo sipas nevojës edhe kryeinxhinierit.

Vartësit e Drejtpërdrejtë: Bashkëpunon me inxhinierin e kryerjes si dhe inxhinierin përgjegjës si dhe personelin tjetër në grupin përkatës.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Shkollimi:

Shkolla e mesme teknike ose elektroteknike

Dega/drejtimi/lëmia:

Elektroteknika

Profili:

1) Teknik i elektronikes;

2) Teknik i mekatronikes

Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip.

Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës.

Nivel të lartë të motivimit, iniciativë, vendosmëria, intuita dhe vëmendje në detaje.

Nivel të lartë të etikës profesionale

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- a. Aplikacionin-CV-në e shkarkoni nga web faqja e KEK-ut dhe të plotësohet, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: “ **Ngarko Aplikacionin-CV-në e plotësuar**”
- b. Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës së mesme** (ose **Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme**) e skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza “**Ngarko dëshmitë e kualifikimit**”. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimi i nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online. Dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkesave në konkurs. Pas aplikimit të suksesshëm do të pranoni një email për konfirmim. Nëse nuk keni pranuar emailin konfirmues, atëherë kontaktoni në nr e tel. 038 501-401-2671, ose shkruani në email adresën ofertapune@kek-energy.com (vetëm në rastin kur pas aplikimit nuk e keni pranuar e-mailin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet në tabelën e shpalljeve në KEK, gjithashtu kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi, duke respektuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetëpërshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Testimi do të bëhet në formë elektronike ashtu që vlerësimi do të jetë automatik.

Procesi i testimit dhe intervistimit për kandidatët e suksesshëm me qëllim të transparencës do të monitorohet nga kamerat.

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, në veçanti ato të gjinisë femërore, të aplikojnë për pozitat e publikuara.

Për më shumë informata për pozitat e lartpërmendura vizitoni web faqen: www.kek-energy.com, ikona ‘Shpallje’ dhe mund ta shkarkoni **aplikacionin-CV-në** për pozitën që dëshironi të aplikoni.

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (me shkrim dhe me gojë) përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/I-044.

Vërejtje: Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim:

Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes së ngushtë ju punon në KEK, në cilëndo fazë që vërtetohet aplikacionet-CV-të e juaja do të refuzohen.

Aplikacionet-CV-të pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.

Kandidatët me kualifikime më të larta shkollore (beqelor, inxhinier, master) nuk do të kenë përparësi.

Kandidatët e suksesshëm do të sistemohen në pozitën për të cilën kanë aplikuar sipas kësaj shpallje. Nëse tregojnë performancë të mirë ata/ato do të sistemohen në vendin e punës që është i lirë sipas skemave organizative dhe në afatin prej 3 (tre) viteve nga dita e kontratës së parë nuk kenë të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës, përveç në raste të jashtëzakonshme me lejin e KE të KEK.

Kalendari i përafërt: brenda 25 dite testi me shkrim, brenda 25 dite intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 dite nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA01/2024.

Data e aplikimit deri më 02.05.2024 ora 24:00

Prishtinë, 16.04.2024

Divizioni i Burimeve Njerëzore

